KUVENDI
NR 2790/1 DATE 19.07.24

# ALBANIAN INSTITUTE of SCIENCE

**Për:** Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian"

**Nga:** Instituti Shqiptar i Shkencave (OJF), promotor tw Open Data Albania

**Lënda:** Kthim Përgjigje Ftesën për bashkëpunim Nr. protokolli 2790/2024

**Data:** 17.07.2024

**I nderuar zoti Fatmir Xhafaj,**

Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian".

**Të nderuar Deputet Anëtar të Komisionit,**

Në emër të Organizatës Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS), organizatë Promotore e Open Data ju falënderoj për ftesën për bashkëpunim me nr. protokolli 2790 datë 10.07.2024. Gjithashtu duke përfituar nga rasti , në emër edhe të ekipit që punon pranë organizatës tonë, ju uroj suksese në Punën e Komisionit tuaj dhe forcimin e rolit të Parlamentit në Mirëqeverisje, Sundim të Ligjit dhe Antikorruspion.

Në vijim të ftesës tuaj, lutem gjeni shprehjen tonë të interesit për Komponentin "Mirëqeverisje" dhe detajuar në Objektiva që lidhen me

a. Sfida të Qeverisjes së Hapur (OGP challenge[1]) Shteti Shqiptar ka Angazhim.
b. Agjendën Dixhitale të Qeverisë Shqiptare si Axhendë e Transformimit Digjital.

Më konkretisht e shohim pjesëmarrjen e mundshme të organizatës tonë në konsultim, dialogimin, kontribut dhe pjesëmarrje pranë Komisionit dhe strukturave te tij për komponentin mbi "Mirëqeverisje" që lidhet me përmirësim dhe Eficensë e Databazave Publike dhe aplikimin e Inovacionit dhe dixhitalizimit në sektor si Prokurimi Publik, Regjistri i Pronarëve Përfitues, Regjistri i Biznesit etj.

Në rast se komisioni juaj apo sekretariatet teknike do të krijojë grupe pune, dëgjesa me palë institucionale apo do të shqyrtojë dokumente dhe akte me fokus tek Reforma për Qeverisje të Mirë, sipas parimeve dhe sfidave të Qeverisjes së Hapur, ne do të dëshironim të ishim pjesë e dialogimit dhe konsultimit.

Në raste të caktuara duke u njohur edhe terma reference (ToRs) të mirë-formuluara nga Institucioni, mund të ofrojmë edhe ekspert lokal të angazhuar dhe me eksperience ne Fusha të sipërpërmendura.

Sa i takon eksperiencës së organizatës në Antikorruspion dhe Qeverisje të Mirë përmes Qeverisjes së Hapur (OpenGov), po listoj disa DataBaza te Pilotuara nga Organizata AIS me të dhëna Publike për transparencë dhe Antikorruspion dhe disa dokumente publike të harruara në kuadër të Kontrollit Financiar dhe Prokurimit Publik.

Databaza të Pilotuara nga aktor jo-qeveritar, me Modele OpenGov:

1. SpendingDataAlbania të dhëna të hapura, të mirë strukturuara , konsistent në kohë dhe të lehtësisht të përdorshme për Transaksione Thesari, të gjitha Institucionet Buxhetore në Republikën e Shqipërisë https://spending.data.al/sq/treasury/list/year/2019
2. Open Procurement Albania pilotim i Pasaportës elektronike të tenderit dhe Sistemit të Vlersimit të Riskut https://openprocurement.al/
3. Open Corporates Albania, Regjistri i Hapur i Bizneseve Shqiptare dhe Regjistri i Pronësisë Finale pilotim nga AIS promotor i Open Data për Shqipërinë Open Corporates Albania

Dokumente Politikash te Organizatës:

- Kontrolli i Integritetit të Kontraktorëvë Publik, Praktika EU dhe Kontraktimi në Kontekstin Shqiptar[2]
- Amnistisë Fiskale Çështje dhe Problematika të Harmonizimit me Legjislacionin Penal[3]
- Roli i Parlamentin në Efektivitetin e Politikave Fiskale[4]
- Çështje të Pastrimit të Parave në Kontekstin e Amnistisë Fiskale dhe Penale[5]
- Kontrolli Financiar dhe procesi i hapjes së Negociatave për Kapitullin 32[6]
- Mbi nevojën për Ndryshime dhe Konsultimin Publik mbi Sektorin e Prokurimit Publik[7]

Duke ju uruar suksese në Punën tuaj për forcimin e Rolit të Kuvendit në çështje që lidhen me Mirëqeverisjen, Antikorruspion, Sundimin e Ligjit,

Me respekt

Aranita BRAHAJ

Drejtore Ekzekutive – Instituti Shqiptar i Shkencave

Email: aranita.brahaj@ais.al

[1] The Open Gov Challenge (opengovpartnership.org)

[2] https://ais.al/new/wp-content/uploads/Kontrolli-i-integritetit-te-kontraktoreve-publik-praktikat-EU-dhe-kontraktimi-ne-Kontekstin-Shqiptar-1.pdf
[3] Amnistia-Fiskale-Ceshtje-dhe-Problematika-te-Harmonizimit-me-Legjislacionin-Penal.pdf (ais.al)
[4] Rekomandime-Parlamenti-Efektivitetin-Politikave-Fiskale-P.-Milo-AIS.pdf
[5] Pastrimi-i-Parave-ne-Kontekstin-e-Amnistise-Fiskale-dhe-Penale.pdf (ais.al)
[6] PP_VERSION_SHQIP_FINAL_Kontrolli-financiar-dhe-procesi-i-hapjes-se-negociatave-per-Kapitullin-32.pdf (ais.al)
[7] Aktivitete – Faqe 2 – Albanian Institute of Science (ais.al)

ALBANIAN INSTITUTE of SCIENCE

**Për:** Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian"

**Nga:** Instituti Shqiptar i Shkencave (OJF), promotor të Open Data Albania

**Lënda:** Kthim Përgjigje Ftesën për bashkëpunim Nr. protokolli 2790/2024

**Data:** 17.07.2024

**I nderuar zoti Fatmir Xhafaj,**

Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian".

**Të nderuar Deputet Anëtar të Komisionit,**

Në emër të Organizatës Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS), organizatë Promotore e Open Data ju falënderoj për ftesën për bashkëpunim me nr. protokolli 2790 datë 10.07.2024. Gjithashtu duke përfituar nga rasti , në emër edhe të ekipit që punon pranë organizatës tonë, ju uroj suksese në Punën e Komisionit tuaj dhe forcimin e rolit të Parlamentit në Mirëqeverisje, Sundim të Ligjit dhe Antikorruspion.

Në vijim të ftesës tuaj, lutem gjeni shprehjen tonë të interesit për Komponentin "Mirëqeverisje" dhe detajuar në Objektiva që lidhen me

a. Sfida të Qeverisjes së Hapur (OGP challenge[1]) Shteti Shqiptar ka Angazhim.
b. Agjendën Dixhitale të Qeverisë Shqiptare si Axhendë e Transformimit Digjital.

Më konkretisht e shohim pjesëmarrjen e mundshme të organizatës tonë në konsultim, dialogimin, kontribut dhe pjesëmarrje pranë Komisionit dhe strukturave te tij për komponentin mbi "Mirëqeverisje" që lidhet me përmirësim dhe Eficensë e Databazave Publike dhe aplikimin e Inovacionit dhe dixhitalizimit në sektor si Prokurimi Publik, Regjistri i Pronarëve Përfitues, Regjistri i Biznesit etj.

Në rast se komisioni juaj apo sekretariatet teknike do të krijojë grupe pune, dëgjesa me palë institucionale apo do të shqyrtojë dokumente dhe akte me fokus tek Reforma për Qeverisje të Mirë, sipas parimeve dhe sfidave të Qeverisjes së Hapur, ne do të dëshironim të ishim pjesë e dialogimit dhe konsultimit.

Në raste të caktuara duke u njohur edhe terma reference (ToRs) të mirë-formuluara nga Institucioni, mund të ofrojmë edhe ekspert lokal të angazhuar dhe me eksperience ne Fusha të sipërpërmendura.

Sa i takon eksperiencës së organizatës në Antikorruspion dhe Qeverisje të Mirë përmes Qeverisjes së Hapur (OpenGov), po listoj disa DataBaza te Pilotuara nga Organizata AIS me të dhëna Publike për transparencë dhe Antikorruspion dhe disa dokumente publike të harruara në kuadër të Kontrollit Financiar dhe Prokurimit Publik.

Databaza të Pilotuara nga aktor jo-qeveritar, me Modele OpenGov:

1. SpendingDataAlbania të dhëna të hapura, të mirë strukturuara , konsistent në kohë dhe të lehtësisht të përdorshme për Transaksione Thesari, të gjitha Institucionet Buxhetore në Republikën e Shqipërisë https://spending.data.al/sq/treasury/list/year/2019
2. Open Procurement Albania pilotim i Pasaportës elektronike të tenderit dhe Sistemit të Vlersimit të Riskut https://openprocurement.al/
3. Open Corporates Albania, Regjistri i Hapur i Bizneseve Shqiptare dhe Regjistri i Pronësisë Finale pilotim nga AIS promotor i Open Data për Shqipërinë Open Corporates Albania

Dokumente Politikash te Organizatës:

- Kontrolli i Integritetit të Kontraktorëvë Publik, Praktika EU dhe Kontraktimi në Kontekstin Shqiptar[2]
- Amnistisë Fiskale Çështje dhe Problematika të Harmonizimit me Legjislacionin Penal[3]
- Roli i Parlamentin në Efektivitetin e Politikave Fiskale[4]
- Çështje të Pastrimit të Parave në Kontekstin e Amnistisë Fiskale dhe Penale[5]
- Kontrolli Financiar dhe procesi i hapjes së Negociatave për Kapitullin 32[6]
- Mbi nevojën për Ndryshime dhe Konsultimin Publik mbi Sektorin e Prokurimit Publik[7]

Duke ju uruar suksese në Punën tuaj për forcimin e Rolit të Kuvendit në çështje që lidhen me Mirëqeverisjen, Antikorruspion, Sundimin e Ligjit,

Me respekt

Aranita BRAHAJ

Drejtore Ekzekutive – Instituti Shqiptar i Shkencave

Email: aranita.brahaj@ais.al

[1] The Open Gov Challenge (opengovpartnership.org)

[2] https://ais.al/new/wp-content/uploads/Kontrolli-i-integritetit-te-kontraktoreve-publik-praktikat-EU-dhe-kontraktimi-ne-Kontekstin-Shqiptar-1.pdf
[3] Amnistia-Fiskale-Ceshtje-dhe-Problematika-te-Harmonizimit-me-Legjislacionin-Penal.pdf (ais.al)
[4] Rekomandime-Parlamenti-Efektivitetin-Politikave-Fiskale-P.-Milo-AIS.pdf
[5] Pastrimi-i-Parave-ne-Kontekstin-e-Amnistise-Fiskale-dhe-Penale.pdf (ais.al)
[6] PP_VERSION_SHQIP_FINAL_Kontrolli-financiar-dhe-procesi-i-hapjes-se-negociatave-per-Kapitullin-32.pdf (ais.al)
[7] Aktivitete – Faqe 2 – Albanian Institute of Science (ais.al)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KUVENDI**
**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 2790 prot.

Tiranë, më 10.07.2024

Lënda: Dërgimi i shkresës së Kryetarit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar

**Znj. Aranita BRAHAJ**

**ALBANIAN INSTITUTE OF SCIENCE (AIS)**

*E nderuar Znj. Brahaj,*

Ju lutem gjeni bashkëlidhur shkresën e Z. Fatmir Xhafaj, Kryetarit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian".

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Genci Gjonçaj**

**NË MUNGESË DHE AUTORIZIM**
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM I SHËRBIMIT LEGJISLATIV**

**Merita Qato**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Adresa:Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.4,Tiranë-Shqipëri
http://www.parlament.al
Telefon/faks:00355 42232599/2228698
e-mail: Genci.Gjonçaj@parlament.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KUVENDI**
**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR**

Nr. 2790 prot. Tiranë, më 10.07. 2024

Lënda: Ftesë për bashkëpunim.

**ZNJ. ARANITA BRAHAJ**
**ALBANIAN INSTITUTE OF SCIENCE (AIS)**

Tiranë

**E nderuar znj. Brahaj,**

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 27.5.2024, miratoi Rezolutën "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", dhe në zbatim të saj, me Vendimin Nr. 50/2024 ka miratuar ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian" ("Komisioni i Posaçëm Parlamentar') dhe në vijim me Vendimin Nr. 53/2024 ka përcaktuar përbërjen e këtij Komisioni.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar në mbledhjen e tij të datës 14.06.2024 vendosi t'ju drejtohet me një "*Ftesë për Bashkëpunim*", Organizatave të Shoqërisë Civile me përvojë dhe kontribute në këto tre fusha, i) mirëqeverisja, ii) antikorrupsioni dhe iii) sundimi i ligjit.

Bazuar mbi këtë vendimmarrje të komisionit, kam kënaqësinë ti drejtohem organizatës suaj, duke ju ftuar të bëheni pjesë e këtij proçesi dhe nëse e shihni të arsyeshme, të mund të jepni kontributin tuaj në këtë proçes edhe me ekspertizë konkrete duke u përfaqësuar me ekspertë me përvojë të spikatur pranë Grupeve të Ekspertëve ose dhe ekspertë më të rinj pranë Sekretariatit Teknik, struktura që do të ngrihen pranë këtij komisioni dhe përmes të cilave do të hartohen aktet dhe dokumentat që do ti prezantohen Komisionit të Posacëm Parlamentar, për shqyrtim e miratim. Ne do ta vlerësonim shumë prezencën e ekspertizës tuaj dhe do të mirëprisnim me shumë interes, propozimet tuaja konkrete.

Duke vlerësuar rolin dhe kontributin tuaj në vite në këto fusha, ne shprehim gjithashtu interes të veçantë për tu njohur me dokumente të hartuara nga organizata juaj, në 5 vitet e fundit, për fushat që lidhen me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së këtij komisioni, të cilat do të na shërbenin shumë për i) proçesin e analizës, ii) hartimin e strategjisë e planit të veprimit dhe iii) propozimet e mundshme për ndryshime ligjore sipas objektit të punës së këtij komisioni, përcaktuar nga Kuvendi.

Informacioni i mësipërm mund të dërgohet në adresën elektronike: KomisioniPosacem@parlament.al mundësisht brenda datës 17.07.2024.

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.4, Tiranë, Shqipëri; Tel: 042221202
KomisioniPosacem@parlament.al fatmir.xhafaj@parlament.al

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, për sa më sipër, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të mëtejshëm.

Me konsideratë,

**Kryetari i Komisionit**

**Fatmir Xhafaj**